



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 722/4 Prot

Tiranë, më 29.07.2016

VENDIM

Nr. 43, datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 162 datë 27.06.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë", me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi "Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë", gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin nr. 162 datë 27.06.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk ka njoftuar Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi nuk ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar "Deklaratën e Konfidencialitetit" me punëmarrësit, por e ka aplikuar këtë dokument vetëm me koordinatorët e maturës shtetërore.
4. Kontrolluesi ruan dokumentacionin e aplikantëve për mësues nga viti 2014;
5. Kontrolluesi/Institucioni ka vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike ([dargjirokaster@arsimi.gov.al](mailto:dargjirokaster@arsimi.gov.al)) dhe komunikimet e tjera kryhen nëpërmjet adresave personale të punonjësve.
6. Nuk ka rregulla për kohën e ruajtjes së të dhënave që përpunojnë psikologët.

**Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.**

Për shkeljet e konstatuara, është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 07.07.2016, në të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime.

**Në cilësinë e provës materiale, procesverbalit i janë bashkëngjitur dokumentet e mëposhtme:**

- Rregullore e brendshme funksionimi e D.A.R. Gjirokastrë;
- Kopje e dokumenteve personale të aplikantëve për mësues për vitin 2014;
- Kopje e protokollit për zbatimin e Udhëzimit nr. 12 të vitit 2015 të M.A.S.;

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ pranë kontrolluesit, udhëzimeve 12/2015, 38/2015, 40/2015 të MAS, akteve nënligjore të miratuara nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe pretendimeve të kontrolluesit, u konkludua se:

1. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ nga inspektorët e K.D.I.M.D.P.- së, është konstatuar se kontrolluesi nuk kishte njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.  
Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 21 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ nga inspektorët e K.D.I.M.D.P.- së, është konstatuar se kontrolluesi nuk dispononte “Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale”.  
Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 27 të ligjit për arsye se ai nuk ka hartuar rregullore specifike për “Mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, ku një detyrim i tillë është edhe në përmbushje të Vendimit nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” dhe pikës 19, kreu “I” të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S. në të cilin është parashikuar gjithashtu hartimi i rregullores së brendshme të institucioneve arsimore për të dhënat personale të subjekteve.
3. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ nga inspektorët e K.D.I.M.D.P.- së, është konstatuar se Kontrolluesi nuk ka nënshkruar “Deklaratën e Konfidencialitetit” me punëmarrësit, por e ka aplikuar këtë dokument vetëm me koordinatorët e maturës shtetërore. Nënshkrimi i “Deklaratës së Konfidencialitetit” me të gjithë punëmarrësit është një detyrim ligjor i cili është parashikuar në nenin 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Vendimin nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” si dhe në pikën 19, kreu “I” të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S.  
Nënshkrimi i Deklaratës së Konfidencialitetit nga koordinatorët e maturës shtetërore, është kryer në kuadër të një procesi/veprimtarie specifike të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe për këtë arsye, nuk mund të jetë në përmbushje të

detyrimin ligjor të kontrolluesit. Drejtuesit, punëmarrësit e D.A.R., mësuesit, psikologët, punonjësit socialë etj., janë persona përgjegjës të cilët në varësi të përshkrimit të punës, krijojnë, arkivojnë, ruajnë, transmetojnë etj., të dhëna personale të subjekteve të të dhënave "mësues" dhe/ose "nxënës", dhe për këtë arsye, nënshkrimi i "Deklaratës së Konfidencialitetit" prej tyre është angazhim dhe detyrim ligjor.

Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 28 të ligjit duke mos hartuar dhe nënshkruar Deklaratën e Konfidencialitetit me të gjithë punëmarrësit e tij.

4. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ nga inspektorët e K.D.I.M.D.P.-së, është konstatuar se kontrolluesi ruan dokumentacionin e aplikantëve për mësues, nga viti 2014.

Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të neneve 5, 6 dhe 27 të ligjit për arsye se D.A.R.-Gjirokastër ruan dokumentacionin i cili përmban të dhënat e aplikantëve për mësues, më tepër se sa afati i përcaktuar në nenin 22 të Udhëzimit nr. 40 datë 09/10/2015 të M.A.S.

5. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ, është konstatuar nga inspektorët e K.D.I.M.D.P.-së se dosjet personale të krijuara nga psikologët dhe punonjësit social të gjimnazeve ruhen për një periudhë kohore të pacaktuar. Psikologët dhe punonjësit social, krijojnë dosje me përshkrime respektive edhe për nxënës të cilët mund të jenë problematik dhe krijojnë incidente sociale etj. Konstatohet se nuk ka parashikime ligjore në lidhje me përhapjen, kohën e ruajtjes dhe shkatërrimin e dosjeve të Personave me Aftësi të Kufizuara apo për personat me probleme sociale, mbas mbarimit të qëllimit të përpunimit.

Referuar nenit 5, 6, 7 dhe 27 të Ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Udhëzimit nr. 4/2010 për "Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit", pikat 18 dhe 19 të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S., është përgjegjësi e kontrolluesit marrja e masave teknike dhe organizative për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, transmetimin, shkatërrimin etj. të të dhënave personale.

Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të neneve 5, 6 dhe 27 të ligjit për arsye se nuk ka marrë masa të përshtatshme në lidhje me kohën e ruajtjes, transmetimin dhe shkatërrimin e të dhënave që përmbajnë dosjet personale të subjekteve "nxënës", të krijuara nga psikologët e shkollave, në përfundim të qëllimit të përpunimit.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datë 19.07.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti pretendimet e mëposhtme:

- 1) Më datë 11.07.2016 ka dalë Urdhri nr. 83 ku është urdhëruar marrja e masave për zbatimin e detyrave të lëna në procesverbalin e inspektimit nr. 1924 prot. datë 07.07.2016;

- 2) Me shkresën nr. 2009 datë 11.07.2016 është hartuar plani i masave mbi zbatimin e detyrave të inspektimit;
- 3) Më datën 11.07.2016 në ambientet e D.A.R.-Gjirokastrë është zhvilluar një takim me titullarët e institucioneve arsimore të Qarkut Gjirokastrë ku është bërë me dije se bazuar në Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 12 të MAS datë 27.04.2015 "*Për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale*" në sistemin arsimor parauniversitar, shtojca 3 "*Deklarata e Konfidencialitetit*" do të nënshkruhet nga të gjithë punonjësit arsimor dhe do të bëhet pjesë e dosjes personale të gjithsecilit, dhe D.A.R. do të njoftohet me shkresë zyrtare nga titullari i institucionit arsimor për masat e marra;
- 4) Është ngritur grupi i punës për përpunimin e Rregullores së D.A.R.-Gjirokastrë dhe përfshirjen e neneve lidhur me përpunimin e të dhënave personale.
- 5) Është hartuar dhe nënshkruar Deklaratat e Konfidencialitetit nga të gjithë punonjësit dhe është bërë pjesë e dosjes personale të gjithsecilit.

Referuar protokollit të brendshëm dhe sistemit elektronik të subjekteve kontrollues të K.D.I.M.D.P.-së, konstatohet se Kontrolluesi "*Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë*", e ka përmbushur detyrimin për "*Njoftim*" më datë 27.07.2016.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika "l", shkronja "d", "dh" e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë "*kundërvajtje administrative*" dhe sanksionohen me gjobë:

- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- "dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."

Kontrolluesi "*Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë*", në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën "l" të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e mësipërme konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave "*mësues*" dhe "*nxënës*".

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 21, 27, 28, 39/1 shkronjat "d", "dh" dhe 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë, me gjobë në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi të hartojë Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me Vendimin nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për "*Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*" dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S.
4. Kontrolluesi të marrë masa për shkatërrimin e dokumentacionit të aplikantëve për mësues, ku afati në kohë për ruajtjen e të cilit tejkalon afatin e përcaktuar në nenin 22 të Udhëzimit nr. 40 datë 09/10/2015 të M.A.S.
5. Kontrolluesi të marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme në lidhje me kohën e ruajtjes, transmetimin dhe shkatërrimin e të dhënave që përmbajnë dosjet personale të subjekteve "*nxënës*", të krijuara nga psikologët dhe punonjësit social të shkollave, në përfundim të qëllimit të përpunimit.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

